

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhje parlamentare 2021

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi i OSBE /ODIHR	Statusi i implementimit	Komente dhe shënime të tjera
9	Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut, duhet të sigurohet koha dhe burimet e përshtatshme për përgatitjen efektive dhe për mundësi kuptimplota për vëzhgimin publik dhe të pavarur të teknologjive zgjedhore. Në rast të përdorimit të votimit elektronik në shkallë më të gjerë, duhet të merret në konsideratë aplikimi i metodave të verifikimit si auditimet e kufizimit të rrezikut.	Progres i Kënaqshëm	Teknologjia e informacionit përdoret për: -Identifikimin biometrik të zgjedhësve në të gjithë qendrat e votimit. -Votimin elektronik si projekt pilot Sigurimi i transparencës për rritjen e besimit tek publiku aktualisht realizohet nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit prej KQZ të seancave demonstruese. Është e udhës të trajtohet mundësia për monitorimin dhe vlersimin paraprak të funksionimit të teknologjisë së informacionit në zgjedhje duke aktivizuar për këtë qëllim agjenësi ose organizata të pavarura dhe të specializuara.